



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:266223

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05608580

AC-I-23-0404

Në ankesën e

Paditësi

B P, të cilën e përfaqëson avokati B I nga Prishtina.

Kundër

E paditura/Ankuesja

NSH, "Famipa" Prizren (në likuidim), të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. " Agim Ramadani", nr. 23, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1677 të datës 12 qershor 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1677 të datës 12 qershor 2023.**

3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 10 shtator 2015, paditësja e ka dorëzuar një ankesë në DHPGJS dhe ka kërkuar që të anulohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRZ024-0476 i datës 12 shtator 2013, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditëses për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 2,065.00 euro, me arsyetim se për periudhën para lidhjes së Kontratës së privatizimit e njëjta nuk ka qenë punëtore aktiv në ndërmarrje, nuk ka qenë në listën e pagave dhe nuk ka ofruar shërbime pune për NSH-në, andaj ai nuk i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, që ti njihet e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Paditësja në ankesë ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, pasi që marrëdhënia e punës i është ndërprerë me njoftimin e AKP-së, për shkak të privatizimit të NSH-së, andaj ajo pohon se ka të drejtë në kompensim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Me datë 27 mars 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e lëshon një urdhër për paditësen me të cilën kërkon që të dorëzon prova shtesë në mbështetje të ankesës.

Me datë 13 prill 2023, paditësja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë si përgjigje ndaj urdhrit me të cilën ajo dorëzon dokumentet vijuese: kopjen e Librezës së punës të mbyllur me 16 shtator 2011, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 16 shtator 2011, formularin e kërkesës, dhe vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 20 prill 2023, AKP-ja e dorëzon mbrojtjen në ankesë. AKP-ja mbanë qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja pohon se paditësi nuk ka përcaktuar saktë periudhën për të cilën kërkon kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Tutje AKP-ja pohon se sipas listës së pagave të punëtorëve, paditësja nuk ka punuar dhe nuk ka ofruar shërbime për NSH-në, ajo nuk ishte punëtore aktive e NSH-së, prandaj nuk ka të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës të pretenduara

ndaj NSH-së. Në mbrojtën në ankesë ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Me datë 12 qershor 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-15-1677, ankesën e paditëses e aprovoi si të bazuar, e ka ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, dhe e ka detyruar të paditurën që ti paguajë paditëses gjashtë paga në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,770.00 euro, interesin ligjor prej 10 % në shumën themelore si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 124.00 euro, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësja ka dorëzuar njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 16 shtator 2011, kopjen e Librezës së punës e mbyllur me datë 16 shtator 2011, në bazë të cilave prova vërtetohet se paditëses me veprimin e AKP-së si rezultat i privatizimit të NSH-së i është ndërprerë marrëdhënia e punës në NSH. Andaj bazuar në këto prova paditësja ka të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në bazë të nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Tutje Shkalla e I-rë e DHPGJS-së konstaton se bazuar në përvojën e punës që e ka paditësja në NSH, në bazë të nenit 76 paragrafi 7 pika 7.4 të Ligjit të Punës, paditëses për 29 vite shërbim punë në NSH, i takojnë gjashtë paga mujore në shumë prej 295.00 euro ose në shumën e aprovuar prej 1,770.00 euro, si dhe interesi ligjor prej 10 % në shumën themelore, që do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Me datë 04 korrik 2023, AKP-ja (në tekstin e mëtejme ankuesja) në DHPGJS ka dorëzuar një ankesë të afatshme kundër Aktgjyimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-15-1677 të datës 12 qershor 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe ka kërkuar nga Kolegji i Apelit që të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditëses dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se gjetjet faktike të Gjykatës së Shkallës së I-rë janë tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes. Autoriteti i Likuidimit thekson se janë dy afate të ndryshme të parashkrimit të cilat duhet të respektohen, afati i parë është afati për parashtrimin e kërkesave që është një afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit e i cili afat e bënë kërkesën të pranueshme dhe afati i dytë ka të bëjë me meritat e kërkesës e që në

këtë rast ka të bëjë me afatin e parashkrimit i cili është 3 vjet në përputhje me nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. AKP-ja konsideron se paditësja nuk ka qenë në listën e pagave, nuk ishte punëtore aktive e NSH-së dhe se kërkesa e saj për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës është parashkuar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. AKP-ja ka kërkuar nga Kolegji i Apelit të merren në konsideratë argumentet ligjore të ngritura dhe vërtetohet ligjshmëria e vendimit të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 01 shtator 2023, paditësja e dorëzon një parashtrësë në DHPGJS dhe i përgjigjet ankesës së AKP-së. Në këtë parashtrësë paditësja pohon se ajo e mbështet në tersi Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS, ndërsa i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore të AKP-së si të pabazuara në ligj. Tutje paditësja pohon se ajo qëndron ende pranë gjitha thënieve dhe provave të paraqitura para Shkallës së I-rë të DHPGJS në rastin C-IV-15-1677. Andaj nga këto arsye paditësja kërkon që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar Shkallës së I-rë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditëses e datës 05 korrik 2013 për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 2,065.00 euro, refuzohet si e pa bazuar, me arsyetimin se paditësja nuk ishte në marrëdhënie pune

në kohën e privatizimit të NSH-së, dhe ajo nuk ka ofruar asnjë provë se ka punuar për NSH në datën e privatizimit të NSH-së.

Paditësja në ankesën e dorëzuar në DHPGJS me datë 10 shtator 2015, me të cilën ajo e konteston vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRZ024-0476, të datës 12 shtator 2013, ajo kërkon dëmshpërblim për shkak të largimit të saj nga puna si rezultat i privatizimit të NSH-së, dhe atë shtatë paga në bazë të përvojës së saj të punës, në shumë prej 2,065.00 euro.

Paditësja me parashtresën e dorëzuar në DHPGJS me datë 12 prill 2023 si përgjigje ndaj urdhrin të datës 27 mars 2023, ka dorëzuar dokumentet vijuese: kopjen e Librezës së punës të mbyllur me 16 shtator 2011, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 16 shtator 2011, formularin e kërkesës, dhe vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Bazuar në këto prova, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë e kishte aprovuar ankesën dhe kishte ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, duke ia njohur paditëses të drejtën në gjashtë paga bazuar në përvojën e saj të punës në shumë prej 1,770.00 euro, si dhe interesin ligjor prej 10 % në shumën themelore të borxhit të aprovuar.

Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja nuk e konteston lartësinë e pagës së ankuesit, andaj bazuar në këtë fakt, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka aprovuar shumën prej 1,770.00 euro, pasi që një fakt i pa kontestuar duhet të konsiderohet si fakt i provuar.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit vjen në përfundim se paditësja me dëshmitë e ofruara ka provuar se i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, që të i njihet e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,770.00 euro, e cila pagesë do të bëhet sipas prioriteteve të përcaktuara me Ligj në procedurën e likuidimit.

Bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë e ka aprovuar edhe interesin ligjor në shumë prej 10 %, në shumën e

borxhit themelor e që në këtë rast kjo shumë është 177.00 euro, e cila shumë duhet të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

AKP-ja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 26 korrik 2023, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 23 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
